

POLITIKAT EKONOMIKE

Alterglobalizmi – protestë sociale apo
filozofi alternative?

Prof.Dr. Adrian Civici
Universiteti European i Tiranës

Drejt nje „fshati“ global



- ***Shoqerite e sotme post-industriale po karakterizohen nga 5 shkeputje apo nderprerje te elementeve te tyre thelbesore qe ne nje fare menyre jane bere simboli i vendeve te zhvilluara.***

- Te lindura rreth 30 vjet me pare me daljen e kompjuterit te pare “Apple”; me nje shkeputje nga modeli fordist i organizimit te punes; me nje revolucion kulturor e levizje sociale te fuqishme si ajo e viteve 68-te; me nje revolucion financiar te viteve 90-te qe kontrollin e ndermarjeve dhe firmave ja kaloi burses duke i bere aksioneret me te mbrojtur e favorizuar se punonjesit, dhe se fundi me fenomenin me prezent sic eshte ai i “globalizimit”,
- tashme keto vende po hyjne ne nje faze te re zhvillimi e funksionimi te cilesuar si “**post-moderne**”.


- Pervoja «moderne» tregon se **Globalizimi nuk shperndan spontanisht progres e mireqenie, por ato duhen kerkuar nepermjet politikave e zgjidhjeve strategjike nga cdo vend.**
- Ti shmangesh apo thjesht te kerkosh mbrojtje prej tij nuk konsiderohet si zgjidhje inteligjente sepse kjo do te thote ta privosh veten nga efektet dhe mundesite qe te ofron kapitalizmi modern.
- Gjithe ekonomia e vendeve te zhvilluara eshte tashme e perfshire ne kete sistem te ri.
- Futja e fuqishme e Kines, Indise, Brazilit, Rusise, etj., ne tregetine boterore keto vitet e fundit konsiderohet si « etapa e trete e globalizimit kapitalist » pas fazes se pare te globalizimit te shekullit XIX te dominuar nga Anglia dhe fazes se dyte te shek XX te dominuar nga SHBA.

- Ne kete kendveshtrim, « *ekonomia moderne* » po tregon se **bota nuk vuan nga globalizimi i tepert, por nga mungesa e globalizimit;**
- Sa me teper vendet ne zhvillim te investohen ne « tregun e global », aq me kollaj do ta kene te ndjekin rritmin dhe performancen e vendeve te zhvilluara.
- Bota tashme ka hyre ne nje periudhe te re te historise ekonomike.
- **Sfidat nuk jane me vetem ne Europe si ne fillim te shek XIX; ato nuk jane me vetem ne Europe, Ameriken e Veriut apo ne Japoni si gjate shek XX ! Tashme sfida ka perfshire gjithë boten.**

Alterglobalizmi – protestë sociale apo filozofi alternative?



*“një botë tjetër është e mundshme –
bota nuk është mall”*



● Historia dhe përbërja

- Lëvizja “**alterglobaliste**” lindi në fund të viteve 70-të të shek. XX-të, kryesisht në vendet e quajtura “të jugut” apo “në zhvillim” si një formë proteste kundër borxheve, OBT, programeve të axhustimit strukturor të FMN-së, etj.
- Në Europë dhe SHBA kjo lëvizje u shfaq për herë të parë në vitin 1994 në kuadrin e kritikave të forta kundër papunësisë, kushteve të punës dhe mbrojtjes sociale.
- Janë manifestimet masive kundër OBT të Seattle (SHBA) në vitin 1999 ato që shënuan manifestimin më të mediatizuar në shkallë ndërkombëtare të lëvizjes alterglobaliste.
- Më vonë ato u shoqëruan nga shumë evenimente sociale botërore, kontinentale e lokale si “Forumi social botëror” parë si një organizëm alternativ i “Forumit ekonomik botëror” të Davos-it, forumet sociale të Gjenevës, Porto Alegre-s, Firences, Athinës, Mumbai-t (Kongo), etj.

“Alterglobalistet” u konturuan :



- si një lëvizje e shoqërisë civile që konteston modelin liberal të globalizimit;
- që rivendikon një model zhvillimi me afër zhvillimit human, parimit të barazisë në zhvillim dhe mbrojtjes së natyrës.

- Në thelbin e rivendikimeve të tyre qëndrojnë pozicionet e përbashkëta për “**drejtësinë ekonomike**”, “**autonominë e popujve në vendimet e zhvillimit ekonomik e social**”, “**mbrojtjen e mjedisit**”, “**thelimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe respektimin real të të drejtave themelore të njeriut**”, etj.
- Termi “*alter*” (ndryshe) u fut për herë të parë në vitin 2001, për të bërë dallimin nga termi “*anti*” (kundër) që kishte mbizotëruar që në fillimet e kësaj lëvizjeje, çka nënkuptonte se kjo lëvizje nuk ishte thjesht një lëvizje protestuese kundër globalizimit, por ajo kishte tashmë dhe versionin e saj alternativ të modelit të zhvillimit për financat, tregëtinë dhe ekonominë botërore.

Orientimet specifike të alterglobalisteve:

- ***anit-liberalët***, që kritikojnë modelin e hapjes së plotë të tregjeve dhe liberalizmit ekonomik pa kufij, të cilët kërkojnë një reformim të principeve ekonomike mbi kritere më të forta morale e sociale;
- ***komunistët dhe marksistët***, që janë kundra globalizimit ekonomik kapitalist dhe që kërkojnë një globalizim sipas një modeli më social dhe solidar për popujt e ndryshëm të botës;
- ***nacionalistet, apo “sovranistët”***, që mbrojnë masat dhe politikat proteksioniste në interes të ekonomive kombëtare kundra praktikës neo-liberale të tregjeve ndërkombëtare;

ALTERGLOBALISTET - perberja

- ***pacifistët***, që janë kundra prodhimit dhe tregtisë armëve në botë;
- ***ekologjistët dhe ambjentalistët***, që luftojnë në favor të praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm, reduktimit të emisionit të gazit CO2 në atmosferë, fenomenit të ngrohjes globale, etj.;
- ***reformistët***, që mbrojnë parimet e sovranitetit ushqimor dhe të së drejtës së popujve për tu ushqyer njësoj, të konsiderimit të zhvillimit si një e drejtë fundamentale e njeriut, të reformimit radikal të rolit të OKB, FMN, Bankës Botërore, OBT, etj.

- **Pozicionet dhe kritikate kryesore të alter-globalistëve**



- Megjithë diversitetin dhe heterogjenitetin e saj, fenomen që e ka penguar **lëvizjen alterglobaliste të prodhojë një program politik të qartë** dhe ti drejtojë përkrahësit e saj në një drejtim unik.....
- kjo lëvizje ka kristalizuar tashmë si orientimin e përbashkët “**luftën sociale në favor të një zhvillimi të arsyeshëm**” dhe ka përcaktuar si kundërshtar të saj ideologjik “**neo-liberalizmin**”.

- **Kritikat e alterglobalistëve** bazohen në faktet se :
- diferencat në nivelin e jetesës dhe dominimit të planetit janë thelluar shumë në favor të vendeve të pasura “*të veriut*”,
- se hendeku ndërmjet të pasurve dhe të varfërve po thellohet me shpejtësi,
- se pasiguria ekologjike dhe ndotjet industriale po bëhen të frikshme,
- se efekti serrë nuk po ndalet,
- se OGJM, armët kimike dhe atomike po shfaqen si një bombë me sahat për të ardhmen e planetit.

- **Alterglobalistët konsiderojnë se :**

1. „globalizimi nëpërmjet tregut nuk është sinonim i zhvillimit human“
2. „se nga tregu nuk përfitojnë në mënyrë të barabartë të gjithë,
3. „se rritja e pabarazive dhe varfërisë në botë janë efekte perverse të *“tregut të lire global”* .



- **Sipas alterglobalisteve,**
- **“tregu e redukton njeriun dhe karakterin e tij vetëm te vlerat tregtare”.**
- Drejtimi i ekonomisë së vendeve të varfra dhe atyre në zhvillim **nuk është fryt i ligjeve ekonomike natyrale dhe vullnetit të popujve të këtyre vendeve,** por fryt i politikave të qeverive që ndodhen nën **diktatin** e vazhdueshëm të institucioneve ndërkombëtare si FMN, Banka Botërore, OBT, G 8, etj.
- Ata kërkojnë dhe një **demokratizim e transparencë më të madhe të institucioneve ndërkombëtare** në raport me vendimet që marrin dhe efektet konkrete të tyre për shumë vende e rajone të botës.

Atehere..? Konkluzioni juaj ?

